

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

ASI-2A CO

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K53002402C

NUIS/NIPT

Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6

Adresa

Fier

Albania

9301

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0695451541

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

asi2aco18@gmail.com

E-mail

Administrator Astrit Gjikonaj

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/05/08

Data (viti/muaji/dita)

+355695451541

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-67714-04-28-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Bashkia Vlore

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

27910434

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Sherbim Pastrimi ORIKUM per vitin 2023

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/06/05

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2023/06/05

Numri i njoftimit

Kodi CPV

41

19640000-4

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

LPP Nr.162/2020 Nenet, 2, 3, 18, 22, 74, 109 etj,
VKM per RPP Nr.285 date 19.05.2021

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Ne datën 02.05.2023, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Vlore, ka publikuar DST për “Proçedurën e hapur”, elektronike/ marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për një periudhë kohore për 1(një) vjecare ose 12 muaj me numër reference: REF-67714-04-28-2023, me objekt: “Sherbimi i pastrimit ORIKUM për vitin 2023” me fond limit: 27,910,434 (Njzet e shtatë milion e nentëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e katër) leke pa TVSH.

Shoqëria jone shqyrtoi DST dhe dokumentacionin shoqëruar të hartuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlore, ku kemi konstatuar një sërë mangësi të theksuara që nuk janë në përputhje me LPP nr.162/2020 dhe VKM për PRR nr.285/2021.

Ne lidhje me hartimin e DST Legjislacioni për prokurimin publik ka të përcaktuara qarte mënyrën si hartohen ato.

Ne nenin 3, të LPP nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” citohet shprehimisht :

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Po kështu në nenin 74, të LPP nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” citohet shprehimisht :

Neni 74

Dokumentet e tenderit

1. Autoriteti ose enti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike?.

I drejtohem Agjencisë së Prokurimit Publik duke ju referuar nenit 22, të LPP nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” ku citohet shprehimisht :

Neni 22

Agjencia e Prokurimit Publik

1. Agjencia e Prokurimit Publik mbikëqyr sistemin e prokurimit publik, me qëllim sigurimin e efikasitetit e transparencës në procesin e prokurimit publik. Agjencia e Prokurimit Publik është person juridik, institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë, që financohet nga buxheti i shtetit.

Gjithashtu në nenin 41, të VKM për PRR nr.285/2021 përcaktohet me rigorozitet mënyra si hartohen kriteret e vecanta të kualifikimit për kontratat e shërbimeve ku citohet shprehimisht :

Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlogaritur.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Per tenderin me objekt “Sherbimi i pastrimit ORIKUM per vitin 2023”, shoqeria jone, kontaktoi nje kompani gjigande ne shtetin fqinje Itali per te bashkepunuar ne realizimin e ketij tenderi, per faktin se kerkohet nje sherbim qe kerkon eksperience pune, ku Op.Ek duhet te kene pervojte dhe staf te kualifikuar, teknologji e makineri te cilesise se larte, sepse behet fjale per nje sherbim teper te vecante ne nje zone turistike me ndjeshmeri te larte.

Nga shqyrtimi dokumentave standarte dhe atyre shoqeruese konstatojme mangesi dhe gabime per te cilat po referohemi si me poshte.

SE PARI

Duke ju referuar Objektit te Prokurimit te publikuar ne DST qe eshte “Sherbimi i pastrimit ORIKUM per vitin 2023” konstatojme se kemi te bejme me deklarim ne menyre te gabuar. Kjo per faktin se objekti i prokurimit kufizohet ne afatin kohor deri ne 31.Dhjetor 2023, ndersa fondi limit dhe zbatimi i kontrates jane perlllogaritur per periudhen 12 muaj, qe i takon periudhes 2023-2024.

Keto mosperputhje te afatit konsiderohen serioze nga shoqeria jone dhe vecanerisht nga partneri yne, te cilet shprehen shqetesimin dhe dyshimin per seriozitetin e ketij tenderi, duke vene ne pozita te veshtira bashkepunimin qe per ne eshte shume i rendesishem. Behet fjale per realizimin e nje kontrate qe kerkon te investohen fonde te konsiderueshme ne teknologji dhe makineri-paisje te kushtueshme dhe kufizimet apo pasaktesite per afatin e zbatimit te kontrates jane shqetesuese dhe te papranueshme.

Duke gene se kemi te bejme me nje sherbim te rendesishem sikurse eshte “Sherbimi i pastrimit ORIKUM”, eshte e qarte se nuk lejohen gabime te ketij lloji qe vecse ngaterojne Operatoret Ekonomike, prandaj jemi te detyruar te paraqesim kete ankese.

Afati kohor i zbatimit te kontrates perben anen me te rendesishme juridike dhe financiare, prandaj per vazhdimin e metejshem ky TENDER duhet te rishpallet me afate krejtesisht te qarta dhe teper te sakta.

SE DYTI

Duke ju referuar DST te publikuar ne kapitullin “Njoftime” faqe.2 konstatojme se eshte deklaruar

ne menyre te gabuar objekti i prokurimit, ku shprehimisht eshte :

1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbimi i mirembajtjes te varezave publike dhe te deshmoreve te Bashkise Vlore 19640000-4 Shërbime te ndryshme

Sikurse theksuam me siper, kemi te bejme me nje sherbim te rendesishem sikurse eshte “Sherbimi i pastrimit ne nje zone turistike”, dhe Partneri yne Italian, me te cilin kemi vendosur te bashkepunojme ne kete tender, shprehu shqetesimin dhe dyshimin per seriozitetin e hartimit te dokumentave te ketij tenderi.

SE TRETË

Duke ju referuar DST te publikuar ne kapitullin “Njoftimi i Kontrates” faqe.9 konstatojme se ka deklarime te pa plota apo te gabuara, ku shprehimisht eshte :

4.3 Procedurë e rishpallur:

Po Jo ?

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

- a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit Sherbimi i mirembajtjes se varezave publike dhe te deshmoreve te bashkise vlore
- c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit

Edhe ne kete rast partneri yne ne shtetin fqinje Itali, me te cilin kemi vendosur te bashkepunojme ne kete tender, shprehu shqetesimin dhe dyshimin per seriozitetin e ketij tenderi, pasi nese eshte procedure e RISHPALLUR mungojne te dhenat qe per partnerin tone kane shume rendesi.

SE KATERTI

Duke ju referuar dokumentacionit shoqerues te DST te publikuar sistemin elektronik te prokurimit me emertimin “Raport Analize” pdf, konstatojme se ka mangesi te theksuara ne te dhenat e pikave te vendosjes se kontenjereve per largimin e mbeturinave.

Ne rastin konkret jane paraqitur te dhena te pergjitheshme te cilat nuk ndihmojne OE per te pergatitur oferta serioze dhe te pergjegjeshme.

Ne vleresojme se minimalisht duhet te percaktohen detyrimisht:

- Ku jane vendodhjet e dislokimit te kontenjereve per grumbullimin e mbetjeve.
- Sasite e kontenjereve per sejcilin nga vendodhjet e dislokimit te tyre.
- Distatacat respective te vendodhjeve te vend dislokimit te kontenjereve per grumbullimin e mbetjeve, deri tek vend depozitimi perfundimtar.

Keto mangesi ngrejne dyshime per seriozitetin e ketij tenderi.

Kjo gje eshte evidente nga situatet aktuale e gjendjes se pastrimit ne muajin Prill 2023, ku ne te gjithë teritorin ku kerkohet te realizohet kontrata konstatohen mbeturina te hedhura ne rruge dhe te shperndara jashte konteniereve.

Per shoqerine tone kjo gjendje eshte e papranueshme, pasi ne karakterizohemi nga serioziteti ne pune, cilesi e larte dhe nje mjedis i pastër e miqësor.

Ne te gjithë dokumentacionin e paraqitur per kete tender nga ana e Bashkise Vlore, ne asnje moment nuk eshte parashikuar menyra e bashkepunimit me bizneset e zones turistike. Ne gjykojme se ne DST dhe dokumentat shoqeruese duhet te parashikohen edhe detyrimet qe kane bizneset apo konsumatorët familjare ne lidhje me hedhjen e mbeturinave dhe Op.Ek te kene detyrimin per t'u angazhuar ne respektimin e rregullave qe percaktohen per komunitetet per mbajtjen paster te mjedisit. Ne vendet e Bashkimit European kerkesat per bashkepunimin me bizneset apo konsumatorët familjare jane teper te rendesishme, duke u percaktuar atyre vendet dhe datat e nxjerrjes se mbeturinave, diferencimin e tyre sipas llojeve, ndersa Op.Ek kontraktues kane detyrimin te raportojne kur konstatojne shkeleje te rregullave.

SE PESTI .

Ne piken , KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT , Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit Kodi II.8.A. me qëllim pastrimin dhe larjen e konteniereve , ndersa ne Sipas Ligjit Nr 52 / 2020 “Per lejet e mjedisit “e ndryshuar , Neni 2 (ndryshuar Neni 4 i Ligjit 10448 , date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit “) kodi II .8.A kalon ne Lishencen e tipt B dhe nuk ka lidhje fare me kete veprimtari .

Persa me siper, ne zbatim te kerkesave te LPP Nr.162/2020 “Per Prokurimin publik”, Nenet, 2, 3, 18, 22, 74, 109 etj.,; VKM per RPP Nr.285 date 19.05.2021, kerkojme nga Agjencia e Prokurimit Publik si institucioni kryesor qe mbikëqyr sistemin e prokurimit publik, me qëllim sigurimin e efijencës e transparencës në procesin e prokurimit, KERKOJME :

Te behet pezullimi i proçedures se prokurimit dhe te verifikohen mangesite e konstatuar nga ana jone ne hartimin e DST dhe dokumentacionit shoqerues.

Ne kerkojme ndalimin e vazhdimit te metejshem te ketij TENDERI dhe rishpalljen e tij nga fillimi duke rregulluar te gjitha mangesite dhe gabimet e konstatuara, me qëllim sigurimin e nje gare te ndershme, per te pasur nje kontrate reale dhe ne perputhje me kornizat juridike ne fuqi.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo.

7. Lista e informacionit konfidencial:

Nuk ka.

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. □

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

asi2aco18@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Astrit Gjirkondaj